Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**27.12.2023**	**17.01.2024**	**2023/1049**
Eksperti Teknik **Arben Lajqi**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **04.01.2024**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.12.2023, OE "ELSAM"SHPK"- Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1049, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "B&D Engineering SHPK dhe Novamat SHPK"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Nderrimi i vareseve te gypave integral RA, RB dhe RC, njesite B1&B2 te TC Kosova B" me nr. të prokurimit: "KEK-23-8930-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a..

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 800,000 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:

Njoftimi për kontratë: 23/08/2023

Hapja e ofertave: 06/10/2023

Vendimi i AK-së: 05/12/2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/1049 i dt:25.12.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 11 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Me datën 05.12.2023 autoriteti kontraktues ka publikuar “Njoftimin mbi vendimin e AK “ ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik B&D Enginneering , SH.P.K. dhe NOVAMAT me çmim prej 779,806.07 €.

Po të njëjtën ditë, ne kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderues, e cila qasje na është lejuar me datën 06.12.2023.

Me rastin e ofrimit të qasjes në dokumente, është vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar aneksin 3 kërkesën për konfidencialitet.
Edhe pse është plotësuar aneksi 3 i dosjes së tenderit, OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi e as arsyetime se qasja në dokumentet e tij do të dëmtonte materialisht kompaninë në fjalë.
Tek kërkesa për sekret afarist grupi i OE të rekomanduar për kontratë e ka shënuar si në vijim:
Ne perputhje me te drejten qe parasheh LPP, Neni 11 kerkojme qe oferta tekniko – financiare e dorezuar nga ne te jete konfidenciale.
Dokumentat qe kerkojme te trajtohen si konfidenciale jane:
Dokumentacioni i prodhuesit/ Certifikata te Prodhuesit/ Katalogjet/ vizatimet/ specifikimet teknike/ skedat teknike te prodhuesit.

Autoriteti kontraktues është dashur të analizojë kërkesën për sekret afarist dhe të shqyrtojë se a janë plotësuar kushtet sipas paragrafit 3 të nenit 11 të LPP-së. Nëse nuk janë plotësuar atëherë nuk duhet pranuar kërkesën për sekret afarist. Pavarësisht kësaj, nëse do të ishin plotësuar kushtet që të konsiderohen sekret afarist dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, atëherë AK-së është dashur të përgatit versionin e pastruar të çdo dokumenti.
Këto veprime nuk i ka ndërmarr autoriteti kontraktues, prandaj në këtë rast janë bërë shkelje ligjore të nenit 10 dhe 11 të LPP-së.

Me këto veprime të OE të rekomanduar për kontratë, e veçanërisht të autoritetit kontraktues janë bërë shkelje ligjore të nenit 10 dhe 11 të LPP-së dhe me këtë rast na është pamundësuar neve që të ngritim pretendime konkrete për shkak të mos lejimit të qasjes në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë.

Pavarësisht këtij fakti, gjatë qasjes së pjesshme dhe diskutimet që kemi patur me këtë rast, mendojmë se janë disa dëshmi, mbi të cilat e kemi mbështetur dhe e kemi parashtruar kërkesën tonë për rishqyrtim.
Po ashtu jemi njoftuar se të tre ofertuesit në këtë procedurë prokurimi kemi konkurruar me prodhuesin e njëjtë.

Në nenin 9.1&9.2 të FDT-së është kërkuar:
Pika 2:
2. Mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe ose fotografive dhe vizatime të produkteve që duhet të furnizohen;
Kurse dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar si në vijim:
2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Ne katalog pjese te katalogut sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.

3. Specifikimet teknike të detyrueshme:
3.1 Punët duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit, shih Aneksin 1, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, sasitë, modelet mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera.
3.2 Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikoj tenderin.

Në lidhje me këtë tender ne kemi bërë përgatitje adekuate dhe serioze, duke kontaktuar fillimisht prodhuesin Lisega, ku i njëjti vetëm neve na ka mbështetur plotësisht me dokumentacion dhe ofertë serioze, pasi që neve na ka ofruar autorizimin me Vizatimet

(LICAD), Deklarat per aftësinë e punës, Katalogun General, Referencat, Garancionin, Katalogu i vjetër, etj.
Duke pasur parasysh që vetëm ne e kemi autorizimin nga prodhuesi në krahasim me konkurrentet tjerë tregon se ne jemi kompani e strukturuar mirë dhe serioze në tregun e Kosovës dhe më gjerë dhe në bashkëpunim me prodhues të ndryshëm, prandaj me mirëkuptim kërkojmë që të trajtohet me kujdesin e duhur ankesa jonë dhe aq më tepër kur kem parasysh faktin se ne si kompani nuk parashtrojmë ankesa të panevojshme dhe të paarsyeshme në OSHP. Ky fakt mund të vërtetohet lehtë nëse analizohet historiati i ankesave tek OSHP.

Ne diskutimet me prodhuesin Lisega na është sqaruar ndryshimi në mes te varësve te vjetra (egzistuse) dhe varsëve te reja qe kompania Lisega i prodhon.

Prodhuesi Lisega ka konstatuar se këto Varrse te gypave të kërkuara nga autoriteti kontraktuese janë prodhime të vjetra në kompaninë e tyre dhe se tani ka avancuar teknologjia dhe kemi avancim të prodhimeve në këtë drejtim.
Ne takimin tone ne kemi kërku nga prodhuesi që ti përmbahen specifikave teknike te projektit, vizatimet e ofruara nga AK me tipin e lidhëses se gypave
si psh:
VIZATIMI SVS 29, brenda vizatimit është kërku tipi i amortizatorëve te jete 3068 dhe



Ne dosje të tenderit është kërkuar pjese të katalogut me specifikime teknike te kërkuara te nënvizohen për pozicionet e kërkuara.

Në takimin që kemi pasur me përfaqësues të këtij prodhuesi, kemi kerku katalogun e vjetër nga Lisega dhe ky katalog na është dorëzu fizikisht ne takimin tonë dhe bashkërisht kemi bërë listën e kërkesave sipas katalogut te vjetër dhe jemi siguruar që varëset të punohen sipas katalogut te vjetër.
Ne, me dosje të tenderit kemi bashkangjitur katalogun e vjetër me listen a varëseve te nënvizuar me artikujt qe kërkohen nga AK duke ju përmbajtur dosjes se tenderit. Katalogu i vjetër sipas prodhuesit Lisega na është dërguar vetëm neve për ofertim dhe ky fakt tregon dhe dëshmon se vetëm ne kemi ofertuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe specifikimeve teknike.

Sa i përket ofertës së Grupit të operatorëve ekonomik B&D Enginneering SH.P.K. dhe NOVAMAT , dyshojmë se ky grup nuk e posedon të gjithë dokumentacionin e plotë dhe nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit.

Edhe nga njohuritë që kemi në aspektin e përgjithshëm, e edhe nga kontakti për prodhuesin, dyshojmë se Vizatimet e ofruar nga LISEGA (LICAD) për OE e rekomanduar për kontratë, nuk janë ne përputhshmëri me vizatimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues. Dyshojmë se tek këto vizatime mungon tipi i lidhëses, dimensionet e lidhëses.

Vizatimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues, janë vizatime te detyrueshme që do të përdoren sipas kërkesës se AK-së natyrisht duke e cekur edhe tipin e lidhëses, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Në krahasim me OE e rekomanduar për kontratë, ne kemi dëshmuar me fakte konkrete, deklaratat, tabelat krahasuese, katalogu i vjetër, se varëset që ne i ofrojmë janë në harmoni me varëset që AK i ka kërkuar (dëshmia e bashkëngjitur).

Sa i përket Deklarimit mbi origjinën e mallrave, ju sqarojmë si në vijim:

- Ne deklaratën tonë mbi origjinën e mallrave e kemi potencuar dhe sqaruar se prodhues i këtyre komponentëve është kompania LISEGA nga Gjermania prej të cilës e kemi pranuar edhe Autorizimin dhe dokumente te tjera përcjellëse si : katalogun e ri dhe katalogun e vjetër, vizatimet e prodhimeve tabelën mbi ekuivalencën e prodhimeve për secilën komponent veç e veç .

- Për shkak se grupi i OE i rekomanduar për kontratë ka klasifikuar dokumentet e prodhuesit si sekret afarist, ne nuk kemi mundur të shofim nëse ky grup i OE ka katalogjet, vizatimet etj , ndërsa jemi njoftuar nga AK-së, se as ky grup i OE e as kompania greke nuk posedojmë Autorizim nga prodhuesi.

- Ne deklaratën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, në lidhje me origjinën e mallrave është shënuar se mallrat do të jenë me origjinë nga EU. Kjo deklaratë nuk përputhet edhe me dëshmitë që janë ofruar nga kjo kompani përkitazi me prodhuesin Lisega. Pra nuk ceket fare kompania LISEGA dhe me këtë nënkuptohet se OE i rekomanduar për kontratë ka lënë hapësira për mundësi manipulimi me rastin e implementimit eventual të këtij projekti. Nëse do të ishte i sigurt se origjina e mallrave që do të furnizohej atëherë do të shënonte emrin e prodhuesit Lisega, por e ka shënuar vetëm EU. Me këtë kuptohet se përse nuk ka autorizim kjo kompani nga pordhuesi Lisega dhe me këtë qartësohet se OE tjerë nuk e kanë mbështetjen e plotë nga prodhuesi sikurse që e kemi ne, me ç 'rast e kemi edhe autorizimin nga prodhuesi Lisega.

  Edhe këto fakte tregojnë shumë dhe ngritin dyshimet se përse janë konsideruar sekret afarist dëshmitë e prodhuesit.

  Kur kemi parasysh faktet dhe dëshmitë e lartcekura, janë evidente dyshimet tona se edhe nëse i kanë dokumentet e prodhuesit, si katalogun, vizatimet e tjera, atëherë shtrohet pyetja se si dhe në çfarë mënyre janë siguruar këto dokumente meqenëse nuk kanë Autorizimin nga prodhuesi. Për të qenë të mbështetur plotësisht dhe për tu përkrahur nga kompania prodhuese duhet të ekzistojë autorizimi i dhënë nga prodhuesi.

- Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka prezantuar si projekt menagjer z. Tonin Petani, ing i lindur më 06.04.1953. Në kontratën e punës së projekt menagjerit thuhet se kontrata është lidhur për periudhën 01.03.2019 – 01.06.2019, me mundësi të rinovimit automatik . Nga kjo kontratë nuk dëshmohet se është bërë vazhdimi i kësaj kontrate dhe ne nuk e dimë nëse z.Tonin Petani është akoma në marrëdhënie pune me kompaninë NOVOMAT. Për më tepër ky inxhinier është 71 vjeçar dhe nuk i lejohet të punojë me orar të rregullt. Nuk kemi asnjë dëshmi nga Autoriteti Tatimor i Republikës se Shqipërisë mbi marrëdhënie pune pas kontratës se skaduar me 01/06/2019 deri te afati i fundit për dorëzim të ofertës dt.06.10.2023. Pra nuk

dëshmohet në asnjë mënyrë se ky inxhinier është në marrëdhënie pune, prandaj për këtë arsye ky OE është i papërgjegjshëm.
Po ashtu edhe në CV e tij kur e përshkruan punën në NIVOMAT e ka shënuar 2018 deri tani. Fjala deri tani nënkupton se ka punuar deri tani dhe kuptohet se tani nuk punon. Pra nuk dëshmohet se ky inxhinier është punëtor i Novomat.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar specifikimet teknike të nënshkruara dhe të vulosura por vetëm ka ofruar një deklaratë për specifikime teknike, prandaj edhe për këtë arsye është i papërgjegjshëm ky grup i operatorëve ekonomik.
Në FDT tek neni 9.1&9.2 është kërkuar **2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Ne katalog pjese te katalogut sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.**

- Po ashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë, nuk ka ofruar me dosje vizatimet e nënshkruara dhe të vulosura.

- Vizatimet e ofruara nga LISEGA (licad) nuk mund të dëshmojnë gjendjen aktuale të prodhimeve ekzistuese, prandaj edhe me këtë fakt kuptohet qartë se ky grup i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka mbështetje të plotë dhe të pa rezervë nga prodhuesi Lisega, ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë se nuk ka autorizim nga prodhuesi.
  Duke pasur parasysh këto fakte atëherë kuptohen qartë mangësitë e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, e të cilat mangësi tregojnë pamundësinë e realizimit të këtij projekti sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Ne me dt.13.12.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cekur se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo nuk ka ofruar fakte dhe prova konkrete për një refuzim të tillë.
Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete në lidhje me pretendimet tona ankimore, prandaj me këtë rast nuk ka respektuar neni 108/A paragrafi 9 të LPP-së ku ceket qartë që :
Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

Pra autoriteti kontraktues edhe e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim edhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret se përse është refuzuar kërkesa për rishqyrtim.
Autoriteti kontraktues e ka cekur se të tre ofertuesit kanë ofertuar me prodhuesin e njëjtë dhe se të tri ofertat kanë qenë të pranueshme, mirëpo në këtë rast autoriteti kontraktues nuk ka marr parasysh dëshmitë e ofruara nga të tre operatorët ekonomik e ku vërehet ndryshim i madh i dëshmive të ofruara, pavarësisht që kanë ofertuar me prodhuesin e njëjtë.
Për dallim prej kompanisë fituese, ne kemi ofruar si dëshmi edhe autorizimin e prodhuesit, pavarësisht që s'është kërkuar, por ky fakt tregon se ne si ofertues kemi mbështetje të plotë nga prodhuesi e jo OE i rekomanduar për kontratë apo ndonjë OE tjetër.

Lidhur me projekt menaxherin është cekur nga ana e AK-së se shihet edhe nga CV se është punëtor i Novomat nga viti 2018, mirëpo ne ju sqarojmë se nuk është CV-ja dëshmi se i njëjti është punëtor i rregullt dhe se ka kontratë të rinovuar me këtë kompani, pavarësisht që në CV nuk shkruan se vazhdon. Me këtë deklarim të AK-së kuptohet qartë se nuk është

arritur të dëshmohet se i njëjti punëtor ka kontratë valide me kompaninë Novomat, prandaj është i papërgjegjshëm ky grup i OE.

Këtë vendim pa përgjigje konkrete dhe pa arsyetim konkret e konsiderojmë si pranim të pretendimeve tona ankimore, prandaj kërkojmë nga OSHP-ja që të shqyrtohen në detaje pretendimet tona ankimore dhe të konstatohet papërgjegjshmëria e OE të rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, pa ndonjë mbështetje ligjore që nuk mund të vërtetojnë për asnjë moment të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Pasi që neve nuk na është lejuar qasje e plotë në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, kërkojmë që të analizohet në tërësi oferta e OE të rekomanduar për kontratë nga eksperti shqyrtues dhe të konstatohet saktë se a i plotëson apo jo të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit apo në të kundërtën të detyrohet autoriteti kontraktues të respektojë nenin 10 dhe 11 të LPP-së duke e përgatitur versionin e pastruar dhe të klasifikojë se cilat dokumente mund të jenë sekret afarist e cilat jo.

Duke pasur parasysh faktet e lartcekura rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët.
Neni 59 paragrafi 4 e parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

Në këtë rast është shkelur dispozita e lartpërmendur sepse grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar tender në përputhshnmëri me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi, kurse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "**Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente**.
Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, ndërsa ju në këtë rast keni vepruar në kundërshtim me këto dispozita dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit pa ndonjë arsye konkrete, duke na eliminuar neve si ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional: **1.Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit; 2. Mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe ose fotografive dhe vizatime të produkteve që duhet të furnizohen; 3.Kualifikimet profesionale dhe edukative të stafit menaxheria 4. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1. Një liste te aktiviteteve të ngjashme të OE qe specifikon punët e kryera, si dhe duhet te prezantoje reference apo certifikate mbi përfundimin apo ekzekutimin e punëve nga punëdhënësi te projekteve me një fushëveprim te ngjashëm për (3) tri vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, me kontaktet për verifikim, nga ku mund të shihet kapaciteti teknik dhe përvoja e tij.** **2.Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjese te katalogut me përshkrim teknike detale për artikujt qe ofertoni. Ne katalog pjese te katalogut sipas specifikimeve teknike te kërkuara te nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.** **3.OE ne oferte duhet te prezantoj menaxherin të projektit. Ai ajo duhet te ketë përvojë pune se paku 3 vite, dhe kërkohet te jetë inxhinier i diplomuar ose master i makinerisë. Te dëshmohet me diplome, CV, kontrate pune.** **4.Operatoret Ekonomik duhet t'i posedoj dhe prezantoj ne ofertë certifikatat •ISO 9001** **• ISO 14001**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
13 -12- 2023
Nr. 8490
PRISHTINË-A

PËR OPERATORIN EKONOMIK	**"ELSAM" SHPK**
NGA	**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS ZYRA EKZEKUTIVE E PROKURIMIT 10000 PRISHTINË, SHESHI NËNA TEREZË NR. 36 DRITON BYTYQI, U.D ZYRTAR PERGJEGJES I PROKURIMIT**
NUMRI I KËRKESËS PËR RISHQYRTIM	**PËRMES SISTEMIT ELEKTRONIK**
DATA E PARASHTRIMIT TË KËRKESËS	**08.12.2023**
SHQYRTIMI I ANKESËS TË PARASHTRUAR	☒ **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK-SË**
TITULLI I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT	**Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC, njësitë B1&B2 të TC Kosova B**
Nr. I AKTIVITETIT TË PROKURIMIT	**KEK-23-8930-5-1-1 KEKC-23-324-511**
DATA E NJOFTIMIT PËR KONTRATË	**29.08.2023**
DATA E PRANIMIT TË TENDERËVE	**17.10.2023**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit në bazë të nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas kërkesës të parashtruar për rishqyrtim nga Operatori Ekonomik "ELSAM" SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC, njësitë B1&B2 të TC Kosova B" me nr. prokurimit KEK-23-8930-5-1-1, Autoriteti Kontraktues mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paraqitur për rishqyrtim nga OE "ELSAM" SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC, njësitë B1&B2 të TC Kosova B" me nr. prokurimit KEK-23-8930-5-1-1.

ARSYETIM

Me datën 10.11.2023, Autoriteti Kontraktues KEK sh.a. ka pranuar kërkesën për rishqyrtim në mënyrë elektronike të parashtruar nga OE "ELSAM" SHPK për aktivitetin e prokurimit "Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC, njësitë B1&B2 të TC Kosova B" me nr. prokurimit KEK-23-8930-5-1-1.

Konform nenit 108/A, të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, pas ekzaminimit të Dosjes së tenderit dhe shqyrtimit të rrjedhjes së procedurës së tenderimit, komisioni profesional vlerësues i Autoritetit Kontraktues në bazë të kërkesës për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik sqaron me sa vijon:

ANALIZA DHE SQARIMI I KOMISIONIT TE VLERESIMIT

Pretendimet ankimore jane te pabazuara pasiqe:

Ne aktivitetin e prokurimit ne fjale tre OE te përgjegjshëm (ne mesin e tyre edhe ju) kane ofertuar me prodhues te njëjtë, si rrjedhoje ofertat kane qene te pranueshme si nga ana teknike ashtu edhe administrative.
Njeherit sqarojmë se nuk ka qene kërkesë e dosjes se tenderit autorizimi andaj OE i rekomanduar nuk mund te eliminohet për kërkesat te cilat nuk kane qene kërkesë e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontrate.

Lidhur me kontratën e Projekt Menaxherit, ne kontratën e prezantuar ceket mundësia e rinovimit automatik njeherit edhe ne CV e projekt menaxherit shihet se nga viti 2018 deri tani është aktiv ne NOVOMAT SHPK.

Duke pare se produktet ne ofertat e dorëzuara nga tre ofertuesit janë me prodhues te njëjtë konsiderojmë se pretendimet ankimore janë te pa bazuara.

REKOMANDIMI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni i vlerësimit rekomandon zyrtarin përgjegjës te prokurimit që kërkesa për rishqyrtim e OE "ELSAM" SHPK për tenderin "Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC" me nr. KEK-23-8930-5-1-1, të refuzohet si e pabazuar.

KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në kërkesën për rishqyrtim e OE "ELSAM" SHPK i cili është i pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit "Ndërrimi i varëseve të gypave integral RA, RB dhe RC" me nr. prokurimit KEK-23-8930-5-1-1, refuzon si te pabazuar ankesën/kërkesën për rishqyrtim te OE.

Këshilla Juridike:
Kundër këtij vendimi, Operatori Ekonomik mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së konform dispozitave ligjore te LPP-se

Vendimi t'i dorëzohet :

1x1 ekzemplar – Operatorit Ekonomik
1x1 ekzemplar – Për dosjen e aktivitetit të Prokurimit
1x1 ekzemplar – Arkivës së KEK-ut

U.D Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

12.2023

Driton Bytyqi

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"ELSAM"SHPK**

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues pas kërkesës së bërë për qasje në ofertën e OE i rekomanduar, i është ofruar një qasje shumë e kufizuar për shkak që sipas AK-së, OE i rekomanduar ka plotësuar Aneksin 3, përmes të cilit ka kërkuar që e gjithë oferta tekniko-financiare e dorëzuar të mbetet konfidenciale, përkatësisht dokumentet të cilat kanë të bëjnë me prodhuesin, certifikatat e prodhuesit, katalogjet, vizatimet, specifikimet teknike dhe skedat teknike të prodhuesit. Kështu, AK ka lejuar qasjen e OE ankues vetëm në disa dokumente të ofertës së OE i rekomanduar pa i përfshirë dokumentet e lartcekura. Neni 10 dhe neni 11 i Ligjit për Prokurimin Publik, lejojnë qasje nga palët e interesuara në ofertat e dorëzuara përmes një kërkesë me shkrim të bërë nga ajo palë, ku lejohet qasja në të gjitha dokumentet përveç atyre që janë deklaruar si sekret afarist nga ana e Operatorëve Ekonomik, por me kusht që këto të dhëna të vërtetohen si të tilla edhe nga ana e Autoritetit përkatës. Pra, në raste të tilla AK duhet të ofroj një version të pastruar të dokumenteve apo të dhënave. Por, gjithashtu duhet të theksojmë se të njëjtat dokumente për të cilat ka kërkuar qasje OE ankues, edhe vet të njëjtat i ka paraqitur si sekret afarist përmes Aneksi 3 në ofertë, përkatësisht vizatimet, katalogjet, referencat dhe dokumentet e prodhuesit në përgjithësi. Edhe pse këto dokumente të kërkuara nuk mund të prezantohen për OE ankues për shkak të plotësimit të Ankesi 3 nga ana e OE i rekomanduar, megjithatë eksperti sqaron se të gjitha dokumentet sipas pretendimeve të ngritura janë analizuar detajisht dhe të njëjtat do të paraqiten edhe para panelit shqyrtues.

Pretendimi 1

"Sa i përket grupit të OE i rekomanduar, dyshojmë se ky grup nuk e posedon të gjithë dokumentacionin e plotë dhe nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Edhe nga njohuritë që kemi në aspektin e përgjithshëm edhe nga kontakti për prodhuesin, dyshojmë se vizatimet e ofruara nga LISEGA (LICAD) për OE i rekomanduar për kontratë, nuk janë në përputhshmëri me vizatimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues. Dyshojmë se tek këto vizatime mungon tipi i lidhëses, dimensionet e lidhëses. Vizatimet e kërkuara nga autoriteti kontraktues, janë vizatime të detyrueshme që do të përdoren sipas kërkesës së AK-së natyrisht duke e cekur edhe tipin e lidhëses, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm."

Sipas ekpsertit teknik, pas shiqimit te ofertave te OE pjesmarrës në ketë aktivitet të prokurimit te cilët kanë qenë 3 operatorë te njejtit kanë prezentuar materialet me të njejtin prodhues LISEGA dhe komplet pozicionet e prezentuara janë të njejta, numrat rendorë në vizatime, nënshkrimet në deklarata, referencat e prodhuesit, etj. Kjo nenkupton qe prodhuesi ju ka dergu të njejtin specifikim teknik, certifikata, nenshkrime dhe të vulosura njejtë 2 operatoreve qe kanë marrë pjesë në ketë aktivitet.

Poashtu lidhur me pretendimin për tabela krahasuese,katalogjet e vjetra ,etj te cilat OE ankues

i prezenton dhe OE i rekomanduarë për kontratë nuk i posedonë nuk qendrojnë pasiqë të njejtat edhe nuk kanë qenë kërkesa të AK dhe nuk janë relevante në ketë rast pasiqë ketë e përcakton qartë **Udhëzuesi Nr 001/2023 për Prokurimin Publik5.5 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, si rregull i përgjithshëm është i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdorët në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët "ose e barasvlershme/ekuivalente",** dhe ketë pretendim eksperti teknik e konsideron si të pabazuar.

Pretendimi 2

"Për shkak se grupi OE i rekomanduar ka klasifikuar dokumentet e prodhuesit si sekrete afarist, ne nuk kemi mundur të shofim nëse ky grup i OE ka katalogjet, vizatimet etj. Ndërsa jemi njoftuar nga AK se as ky grup i OE e as kompania greke nuk posedojnë Autorizim nga prodhuesi. Po ashtu, në deklaratën në lidhje me origjinën e mallrave është shënuar se mallrat do të jenë me origjinë nga EU. Kjo deklaratë nuk përputhet me prodhuesin Lisega. Pra nuk ceket fare kompania LISEGA, me këtë nënkuptohet se OE i rekomanduar ka lënë mundësi manipulimi me rastin e implementimit eventual të këtij projekti. Kur kemi parasysh faktet dhe dëshmitë e lartcekura, atëherë shtrohet pyetja si dhe në çfarë mënyre janë siguruar këto dokumente meqenëse nuk kanë Autorizimin nga prodhuesi."

Eksperti shqyrtues sqaron se për këtë pretendim të ngritur, në Dosje të Tenderit, nuk është kërkuar që OE ofertues të ofrojnë Autorizimin nga prodhuesi, për një kërkesë e cila nuk ka qenë pjesë e DT-së, AK një kërkesë të tillë nuk mund t'a përdorë as për të eleminuar dhe as për të shtuar pikë shtesë për njërin apo tjetrin operator. Ofertat e operatorëve ekonomik, gjithmonë duhet të vlerësohen në bazë të kërkesave dhe dëshmive të përfshira në dosje. Po ashtu, edhe Deklarata e origjinës së produkteve nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, sipas ekspertit deklarata e dorëzuar nga OE i rekomanduar tregon se origjina e këtyre produkteve është EU, ku edhe prodhuesi nga i cili janë sjellë katalogjet e produkteve është pikërisht nga EU. Po ashtu sipas ekspertit teknik, të gjitha vizatimet, katalogjet, certifikatat dhe garancionet janë në emër të këtij prodhuesi-LISEGA, andaj mundësi për manipulim nuk mund të ketë, pasi që një gjë e tillë nuk lejohet nga ana e AK-së si investitor në rastin e nënshkrimit të kontratës. Sa i përket dyshimeve të mënyrës së sigurimit të dokumenteve nga prodhuesi, sqarojmë se nuk është nën përgjegjësinë e ekspertit të verifikoj këto dyshime, për këtë gjë janë organet kompetente. Konsiderojmë që ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 3

"Grupi i OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar si projekt menaxher z. T.P. Në kontratën e punës së projekt menaxherit thuhet se kontrata është lidhur për periudhën 01/03/2019-01/06/2019, me mundësi të rinovimit automatik. Nga kjo kontratë nuk dëshmohet nëse është bërë vazhdimi i kësaj kontrate, apo nëse menaxheri është akoma në mardhënie pune me kompaninë NOVOMAT. Për më tepër ky inxhinier është 71 vjeçar dhe nuk i lejohet të punoj me orar të rregullt. Po ashtu nuk ka asnjë dëshmi nga Autoritet Tatimor i Republikës së Shqipërisë, dhe edhe në CV e tij e përshkruan punën në NIVOMAT e ka shënuar 2018 deri më tani. Fjala deri tani nënkupton se ka punuar deri tani dhe kuptohet se tani nuk punon. Pra nuk dëshmohet se ky inxhinier është punëtor i Novomat."

Sipas kërkesave të DT-së, është kërkuar nga operatorët pjesëmarrës të: *"Të prezantojnë*

menaxherin e projektit. Ai/ ajo duhet të ketë përvojë pune së paku 3 vite, dhe kërkohet të jetë inxhinier i diplomuar ose master i makinerisë. Të dëshmohet me diplomë, CV, kontrate pune." OEi rekomanduar ka dorëzuar për menaxherin e projektit një kontratë (pika 12 e ofertës) në të cilën thuhet se kohëzgjatja e kontratës është me afat të caktuar, përkatësisht zbatimi i kësaj kontrate fillon me datë 01/03/2019 dhe përfundon me datën 01/06/2019 dhe gjithashtu thuhet se kontrata do të rinovohet automatikisht, në mënyrë periodike pas këtij afati nëse palët nuk e kundërshtojnë apo nuk e ndërpresin atë më parë se në afatin e saj të përfundimit. Sipas kontratës së prezantuar, kjo kontratë do të ndërpritej nëse ka ndonjë kundërshtim nga ana e ndonjërës palë, në të kundërtën do të vazhdohet automatikisht. Duke marr parasysh se nuk ka asnjë kundërshtim të paraqitur, atëherë konsiderohet se kontrata është vazhduar automatikisht pas kësaj periudhe ashtu siç është theksuar, andaj konsiderojmë se ky pretendim është i pabazuar.

Sa i përket pjesës së CV-së, përkatësisht pjesa e përvojës së punës ku është cekur se inxhinieri punon që nga viti 2018- deri më tani, eksperti sqaron se në CV shprehjet e tilla dhe të ngjashme përdoren për të treguar se kontrata nuk ka përfunduar andaj nuk mund të shkruhet një datë e përfundimit përderisa punonjësi vazhdon të jetë pjesë e asaj pune dhe pozite, prandaj në vend të datës së përfundimit, gjithmonë përdoren shprehje si ende, vazhdon, deri më tani apo shprehje të ngjashme. Andaj vlerësojmë që kjo pikë e ngritur nuk është e bazuar.

Pretendimi 4

"Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar specifikime teknike të nënshkruara dhe të vulosura por vetëm ka ofruar një deklaratë për specifikime teknike, prandaj edhe për këtë arsye është i papërgjegjshëm ky grup i operatorëve ekonomik. Po ashtu grupi i OE të rekomanduar për kontratë, nuk ka ofruar me dosje vizatimet e nënshkruara dhe të vulosura. Vizatimet e ofruara nga LISEGA (LICAD) nuk mund të dëshmojnë gjendjen aktuale të prodhimeve ekzistuese, prandaj edhe me këtë fakt kuptohet qartë se ky grup i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka mbështetje të plotë dhe të parezervë nga prodhuesi Lisega, ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë se nuk ka autorizim nga prodhuesi."

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të ofertës së OE i rekomanduar sqaron se i njëjti ka dorëzuar edhe dokumentet nga prodhuesi, përkatësisht vizatimet e kërkuara edhe me DT, të njëjtat nga prodhuesi (pika 3 e ofertës), sa i përket pjesës së nënshkrimit dhe vulosjes, kërkesë e dosjes nuk ka qenë që këto vizatime të jenë të vulosura dhe të nëshkruara, megjithatë OE i rekomanduar ka ofruar vizatimet nga prodhuesi, ku këto vizatime përmbajnë të gjitha të dhënat e prodhuesit duke e bërë lehtë të verifikueshme vërtetësinë e tyre nga ana e AK-së. Po ashtu eksperti teknik sqaron se për secilin pozicion të kërkuar, OE dorëzon të dhëna teknike me shifër e cila përputhet me pozicionet e pramasës dhe dosjes së tenderit si dhe me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale tek neni 9.1 dhe 9.2.Vlenë të theksohet që të njejtat i dorëzon edhe OE ankues dhe me të drejtë komisioni i vlerësimit të AK shpallë të përgjegjshëm 3 operatorët pjesëmarrës në ketë aktivitet të prokurimit dhe shpallë fitues operatorin më të favorshëm ekonomikisht sipas Kritereve të dhënies neni 30.1-tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Konsiderojmë që ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 5

“Ne me datë 13/12/2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cekur se e njëjta është e pabazuar, mirëpo nuk ka ofruar fakte dhe prova konkrete për një refuzim të tillë. AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete në lidhje me pretendimet tona ankimore, prandaj me këtë rast nuk ka respektuar neni 108/A paragrafi 9 të LPP-së. Pra AK edhe e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim edhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret se përse është refuzuar kërkesa për rishqyrtim.”

Eksperti shqyrtues sqaron se sipas nenit 108/A të LPP-së, pika 9 thotë se: *“Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë...”.* Sipas mendimit të ekspertit AK edhe pse ka dhënë përgjigje të shkurtër dhe gjysmake, megjithatë është përgjigjur në pretendimet e OE ankues, ashtu siç e ka zgjedhur për t’i arsyetuar këto pretendime. Andaj, vlerësojmë se ky pretendim është i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **"ELSAM"SHPK**

Agnese Ibrahimi

Arben Lajqi